



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2078 prot.

Shkodër, me 30.06.2023

VENDIM

Nr 169, datë 30.06.2023

**"Për nivelin e pagave të personelit administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VKM Nr. 325, date 31.05.2023 , "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile /nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike"; VKM Nr. 326, date 31.05.2023 , " Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" lidhja 1; Udhëzimit të MFE Nr. 16, datë 16.06.2023, "Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile / nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike"; VBA nr 2 datë 09.01.2023 "Për detajimin e grantit 2023 (grant i mësimdhënies", Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 83 , datë 28.03.2023 "Për miratimin e buxhetit 2023", Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 73 , datë 10.03.2023 "Për miratimin e strukturës së USH-së për vitin 2023". Senati Akademik

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave të personelit administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", sipas rekomandimit të MFE-së, referuar VKM-s Nr. 325, date 31.05.2023 , "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile /nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike " lidhja 1), 2), 3), si dhe strukturës organizative të pozicioneve ekzistuese të punës duke i përshtatur me nivele të ngjashme në lidhje të ndryshme të VKM-s sipër cituar, por edhe hierarkisë së pozicionit të punës, sipas përcaktimeve të lidhjes 1).
  - 1.1. Klasa e pagës, niveli i pagës dhe niveli i kualifikimit të pozicionit "Tabela nr. 1", me përshkrimet e pozicioneve si më poshtë:
    - a. Pozicioni nr.1 - "Administrator i Universitetit", të përfshihet në kategorinë "E lartë drejtuese" lidhja nr. 1, klasa I-5, titullar administrativ i institucionit, pasi në ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, neni nr 51, pika 1) përcaktohet: "Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i

*institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji.” Vendosja në këtë nivel page e Administratorit të Universitetit është e tillë që nga përlogaritjet paga bruto e tij nuk duhet të jetë më e lartë se paga bruto e titullarit kryesor të institucionit (Rektorit të Universitetit).*

- b. Pozicioni nr. 2 - “Drejtor drejtorie”, të përfshihet në kategorinë “E mesme drejtuese” lidhja nr. 1, klasa II-2, pasi këto drejtori janë sipas strukturës në Rektorat dhe kanë përgjegjësi për tërë aktivitetin e institucionit, ndërsa bazuar në VKM-n nr. 325, datë 31.05.2023 lidhja nr. 3, pika nr. 5, ç)/IV, masa e shtesës për kushte pune (natyrë të veçantë pune) është 10,000 lekë në muaj për pozicionin “Drejtor drejtorie” me funksion të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.
- c. Pozicioni nr.3 - “Përgjegjës sektori”, të përfshihet në kategorinë “E ulët drejtuese” lidhja nr. 1, klasa III-1/ klasa III-2, duke i ndarë:
- Në nivelin e klasës III-1, të përfshihen sektorët në Rektorat, që kanë nivel më të lartë drejtimi, të cilat janë me rëndësi të veçantë, puna e të cilave ndikon në hartimin dhe zbatimin e politikave të strategjisë së institucionit.
  - Në nivelin e klasës III-2, të përfshihen sektorët në Fakultet, të cilët ngarkesa e punës është më specifike me ndikim jo të drejtpërdrejtë në politikat e strategjisë së institucionit, janë të karakterit mësimor ose mbështetës.
- d. Pozicioni nr. 4, të përfshihet në kategorinë “Ekzekutive” lidhja nr. 1, klasa IV-1, duke i ndarë në:
- “Specialist i nivelit të lartë (në bazën e të dhënave SIFQ/ AFMIS/ TAP/ APP)”, të përfshihen specialistët e nivelit të lartë zbatues, që punën e kanë të lidhur me bazën e të dhënave kombëtare SIFQ/ AFMIS/ TAP/APP, të cilët kanë përgjegjësi në hedhjen e të dhënave, përpunojnë të dhëna dhe printojnë informacione nga këto sisteme në përputhje me aktet nënligjore.
  - “Kryesekretare mësimore”, të përfshihen kryesekretaret mësimore, pasi kanë përgjegjësi direkte në hedhjen e të dhënave të procesit akademik dhe përgatisin informacione për strukturat në fakultet dhe është një pozicion pune në statutin e UE-së.
  - “Kryebibliotekar” të përfshihet pozicioni kryebibliotekar në Bibliotekën qendrore të UE-së.
  - “Specialist me grada e tituj”, të përfshihen pozicionet e specialistëve zbatues të cilët kanë grada shkencore ose kualifikim specifik për pajisje teknike që kërkojnë kualifikim të tillë.
- e. Pozicioni nr. 5, të përfshihet në kategorinë “Ekzekutive” lidhja nr. 1, klasa IV-2, duke i ndarë në:
- “Specialist i nivelit të mesëm”, të përfshihen specialistët zbatues i nivelit të mesëm të pozicioneve të ndryshme të punës në universitet të cilët punojnë në të gjitha njësitë/ drejtoritë apo sektorë të ndryshëm të aktivitetit ndihmës akademik e administrativ.
  - “Specialist i teknikës në laborator”, të përfshihen specialistët e teknikës na laboratorët kërkimor apo mësimor në fakultete.
  - “Specialist portokoll/arkive në Rektorat”, të përfshihen specialistët e portokoll/arkive në Rektorat.
  - “Specialist IT në Rektorat”, të përfshihen specialistët të IT në Rektorat.
  - “Specialist i vlerave materiale e monetare/ banka e të ardhurave me Thesarin” të përfshihet specialisti i vlerave materiale e monetare që punon dhe me bankën e të ardhurave me Thesarin.
  - “Specialist/ laborant në laboratorin kërkimor shkencor FSHN”, të përfshihen specialistët në pozicionin e laborantëve të laboratorit shkencor, të cilët janë specialistë të specialiteteve të ndryshme dhe kryejnë procese të analizve laboratorike me pajisje të akredituara nga institucione ndërkombëtare.
  - “Bibliotekar në bibliotekën qendrore”, “Bibliotekar arkivist në bibliotekën qendrore”, “Klasifikator në bibliotekën qendrore”, të përfshihen pozicionet e bibliotekarit, bibliotekar arkivist dhe klasifikatorit në bibliotekën qendrore.
- f. Pozicioni nr. 6, të përfshihet në kategorinë “Ekzekutive” klasa IV-3, lidhja nr. 1, duke i ndarë në:
- “Sekretar mësimor”, të përfshihen sekretaret mësimor në sekretariatë mësimore në universitet.
  - “Specialist portokoll/arkive në Fakultet”, të përfshihen specialistët e portokoll/arkive në fakultet.
  - “Laborant në fakultet”, të përfshihen Laborantët në fakultet.



- “Bibliotekar në fakultet”, “Bibliotekar arkivist në fakultet”, “Klasifikator në fakultet” të përfshihen pozicionet e bibliotekarit, bibliotekar arkivist dhe klasifikatorit në fakultet.
- 1.2. Niveli i kualifikimit “Tabela nr. 2”,
- 1.3. Shtesa e vjetërsisë paraqitet llogaritet mbi pagën e pozicionit deri në 30 vjet në formë progresive “Tabela nr. 3”,
- 1.4. Masa e shtesës për kushte pune (natyrë të vecantë pune) është 10,000 lekë në muaj për pozicionin “Drejtor drejtorie” me funksion të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.

<b>Tabela nr. 1 - Klasa e pagës, niveli i pagës dhe niveli i kualifikimit për çdo klasë</b>				
Nr	Pozicioni	Klasa e pages	Paga për pozicion	Niveli i kualifikimit
1	Administrator i universitetit	I-5	170,000	1
2	Drejtor drejtorie	II-2	141,000	1
3	Përgjegjës sektori	III-1	115,000	1
		III-2	105,000	1
4	Kryesekretare mësimore Kryebibliotekar	IV-1	80,000	1 ose 2
5	Specialist portokoll/arkive në Rektorat  Specialist IT  Specialist Drejtori tjera në Rektorat	IV-2	70,000	1 ose 2
6	Sekretar mësimor  Sekretar në Fakultet  Laborant në fakultet  Bibliotekar  Klasifikator	IV-3	60,000	1 ose 2 ose 3



Grupi i diplomës	Niveli kualifikimit	Lekë/muaj
1	Master i shkencave / I barasvlefshëm	14,000
2	Master i profesional / I barasvlefshëm	12,000
3	Bachelor/ I barasvlefshëm	10,000

Vite pune	Niveli kualifikimit	Lekë/muaj
3.1	për 10 vitet e para (1-10 vite)	në masën 0.6% në 1 vit pune
3.2	për 10 vitet e dyta (11-20 vite)	në masën 0.8% në 1 vit pune
3.3	për 10 vitet e treta (21-30 vite)	në masën 1% në 1 vit pune

2. Efektet financiare të vendimit të fillojnë nga muaji prill 2023 dhe deklarimi i listëpagesave në sistemin tatimor të kryhet brenda muajit qershor.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit “Luigj Gurakuqi” për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Rajmonda Këçira**

